REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 45, datë 23.10.2025

PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË LEJEN E ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "HOTEL DHE SHËRBIME 2 KAT MBITOKË ME 2 KAT NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË LIVADH, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Sol Luna Group" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në lejen e zhvillimit për objektin: "Hotel dhe shërbime 2 kat mbitokë me 2 kat nëntokë", me vendndodhje në Livadh, Bashkia Himarë, me zhvillues "Sol Luna Group" sh.p.k., miratuar me Vendimin Nr.30, datë 17.03.2021 të KKT-së.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr.30, datë 17.03.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Marrëveshja për Delegimin e Kompetencave cituar në pikën 3 të Vendimit Nr.30, datë 17.03.2021 të KKT-së, lidhur midis Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Bashkisë Himarë, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi.

4. Të gjitha procedurat administrative/ligjore për miratimin e rishikimeve dhe/ose ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit dhe shtyrjen e afateve, si dhe çdo leje e domosdoshme, të parashikuara në VKM-në 408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar, për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, do të vijohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat

ligjore të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të ti, ndërsa çertifikata e përdorimit referuar nenit 27 të VKM-së 408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar, do të lëshohen nga sekretariati teknik i KKTU-së.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 18/09/ 2026